Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Internship**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**3**
Numri i orëve në javë:	**4**
Vlera në kredi – ECTS:	**10**
Përshkrimi i lëndës	Lënda Internship synon përfshirjen e studentëve në procese reale profesionale në fushën e dizajnit grafik dhe multimedias, nga zhvillimi i idesë dhe konceptit deri te realizimi dhe prezantimi i produktit final. Studenti angazhohet në një kompani, studio, agjenci apo organizatë relevante, duke punuar sipas standardeve dhe praktikave profesionale nën mbikëqyrjen e një mentori. Gjatë praktikës, studenti dokumenton proceset e punës, organizimin dhe përvojën profesionale, ndërsa në përfundim harton dhe prezanton një raport mbi aktivitetet, rezultatet dhe kompetencat e fituara.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është që studenti të fitojë përvojë praktike profesionale në kompani, studio, agjenci apo organizata që veprojnë në fushën e dizajnit grafik dhe multimedias, duke aplikuar njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve në situata reale pune dhe duke zhvilluar kompetenca profesionale, komunikuese dhe bashkëpunuese.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: • Aplikojë njohuritë dhe aftësitë e dizajnit grafik dhe multimedias në një mjedis real profesional; • Zhvillojë një projekt nga brief-i dhe konceptimi deri në realizimin e produktit final; • Përdorë mjetet, teknikat dhe standardet profesionale të fushës; • Komunikojë dhe bashkëpunojë në mënyrë profesionale me klientë, mentorë dhe anëtarë të ekipit; • Menaxhojë detyrat dhe afatet gjatë realizimit të projekteve; • Prezantojë dhe argumentojë konceptet dhe zgjidhjet kreative; • Dokumentojë dhe vlerësojë në mënyrë kritike përvojën dhe rezultatet e praktikës profesionale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Takime orientuese / ligjërata	4	4	16
Ushtrime teorike/laboratorike	3	2	6
Praktikë profesionale në kompani/studio/organizatë	8	12	96
Konsultime dhe mentorim	3	6	18
Ushtrime në teren	4	3	12
Kollokviume, seminare			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	5	12	60
Përgatitja e raportit përfundimtar	2	4	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	4	12
Prezantimi dhe vlerësimi	5	2	10
Projektet, prezantimet, etj.	3	4	12
Totali			250
Metodologjia e mësimëdhënies:	Mësimi realizohet kryesisht përmes angazhimit praktik të studentit në një mjedis profesional, nën mbikëqyrjen e mentorit të kompanisë dhe mësimdhënësit përgjegjës. Procesi përfshin punë në projekte reale, konsultime, dokumentimin e aktiviteteve, reflektimin mbi përvojën profesionale, hartimin e raportit përfundimtar dhe prezantimin e rezultateve të praktikës.		
Metodat e vlerësimit:	Struktura e vlerësimit: 40% – Prezantimi dhe raporti përfundimtar i praktikës 60% – Vlerësimi nga kompania/organizata pritëse për performancën e studentit gjatë praktikës Totali: 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Graphic Design Internship Journal: Keep Record of Your Graphic Design Internship Mar 26, 2015 by Frances P Robinson		
Literatura shtesë:	Udhëzues, materiale profesionale dhe dokumentacion teknik i ofruar nga mësimdhënësi dhe organizata pritëse.		

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**

Java e parë:	**Takim orientues me profesorin**: prezantimi i lëndës, objektivave, detyrimeve dhe kritereve të vlerësimit.
Java e dytë:	Udhëzime për dokumentimin e praktikës, shpërndarja e studentëve në kompani/studio/agjenci dhe sqarimi i roleve dhe përgjegjësive.
***Java e tretë*:**	Njohja me mjedisin profesional, strukturën e organizatës dhe analizimi i projekteve të realizuara.
Java e katërt:	Përfshirja në proceset e dizajnit grafik dhe/ose multimedias dhe zhvillimi i koncepteve fillestare.
Java e pestë:	Zhvillimi i materialeve grafike dhe/ose multimediale sipas profilit dhe kërkesave të organizatës.
***Java e gjashtë*:**	Planifikimi i procesit të dizajnit dhe organizimi i fazave të realizimit të projektit.
Java e shtatë:	Zhvillimi i projektit dhe zbatimi i standardeve profesionale të dizajnit.
Java e tetë:	Realizimi teknik dhe përgatitja e produkteve për publikim, shtyp ose platforma digjitale.
Java e nëntë:	Proceset dhe teknologjitë e prodhimit grafik dhe multimedial.
Java e dhjetë:	Kontrolli teknik, cilësia dhe standardet profesionale të produktit final.
***Java e njëmbedhjetë*:**	Komunikimi profesional me klientët, mentorin dhe puna në ekip.
***Java e dymbëdhjetë*:**	Prezantimi dhe argumentimi i konceptit dhe zgjidhjeve kreative.
***Java e trembëdhjetë*:**	Realizimi i projekteve dhe detyrave sipas kërkesave të kompanisë/organizatës.
***Java e katërmbëdhjetë*:**	Përfundimi i projekteve, menaxhimi i afateve dhe dokumentimi i rezultateve të praktikës.
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	Dorëzimi i raportit përfundimtar dhe prezantimi i përvojës dhe rezultateve profesionale.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studenti duhet të respektojë orarin, rregullat dhe standardet profesionale të kompanisë, studios, agjencisë apo organizatës pritëse. Kërkohet vijueshmëri e rregullt, përgjegjësi në realizimin e detyrave, respektim i afateve, komunikim profesional dhe respektim i etikës dhe integritetit akademik e profesional. Studenti është përgjegjës për dokumentimin e aktiviteteve të praktikës dhe dorëzimin e raportit përfundimtar.